

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tedi Blushi i drejtohet Ramës: “Shporrja, dhe vetëm shporrja, është e vetmja zgjidhje që duhet ta marrin në dorë shqiptarët!”
ADRESA	https://kohajone.com/politike/tedi-blushi-i-drejtohet-rames-shporrja-dhe-vetem-shporrja-eshte-e-vetmja-zgjidhje-qe-duhet-ta-marrin-ne-dore-shqiptaret/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 14:15:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 14:12:44 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e0c4423070050bdb6c5f18927997cf3dda80f3a4f29b219832274ca1efa6271c
TEKSTI	1c4e7af368bea563a29a5bf0930acee164396c5dc4ab2cf8693b62e22db0a29d
PAMJA	656e2997161a53eed1a71a01ce4fff453fac8e76b0aec77c1911b18781a5b74f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c327a03d436cbac0285bf5f943d5a39cc42123ba82e9635f1d3e915c004f3f73
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	9def72ec67cc19e19d7afdb89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c327a03d436cbac0285bf5f943d5a39cc42123ba82e9635f1d3e915c004f3f73>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Tedi Blushi i drejtohet Ramës: “Shporrja, dhe vetëm shporrja, është e vetmja zgjidhje që duhet ta marrin në dorë shqiptarët!”

AKTUALITET POLITIKË E DIEL, 27 SHTATOR 2026 16:12



Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë, Tedi Blushi, ka reaguar pas video-mesazhit të kryeministrit Edi Rama, duke kundërshtuar deklaratën e tij se nuk ekziston asnjë vendim apo firmë që e implikon në shkelje të ligjit.

Blushi ngre dy çështje që, sipas tij, lidhen drejtpërdrejt me firmat e kryeministrit, duke përmendur bonusin e dhënë për kompaninë “Integrated Energy BV” dhe procedurën për koncesionin e inceneratorit të Elbasanit.



“Edi Rama vërtetoi sot jo vetëm kartelën e tij klinike, por edhe papërgjegjshmërinë e një kleptomani dhe arrogancën e një banditi, që drejton me gjakftohtësi organizatën kriminale, që ka marrë peng të gjithë shtetin”, shkruan Blushi.



Sipas tij, më 7 dhjetor 2016, Rama ka firmosur dhënien e një bonusi prej 8% të pikëve për kompaninë “Integrated Energy BV” në procedurën konkurruese për ndërtimin e inceneratorit të Tiranës. Blushi pretendon se në momentin kur është firmosur bonusi, kjo kompani nuk ekzistonte.

“Edi Rama, në kundërshtim me çdo ligj në fuqi, më 7.12.2016 firmosi dhënien e bonusit prej 8% të pikëve kompanisë Integrated Energy BV sh.p.k. për procedurën konkurruese për ndërtimin e inceneratorit të Tiranës. Por, në fakt, kjo kompani nuk ekzistonte në momentin kur Kryeministri firmosi bonusin që e favorizonte atë në procedurën konkurruese”, shprehet ai.

Çështja e dytë që ngre sekretari i Përgjithshëm i PL-së lidhet me inceneratorin e Elbasanit. Blushi pretendon se Rama ka firmosur për negociimin pa shpallje të kontratës koncesionare për ndërtimin e inceneratorit, edhe pasi, sipas tij, autoritetet përkatëse ishin njoftuar se procedura ishte e paligjshme.

“Edi Rama ka firmosur, në kundërshtim me ligjin ‘Për koncesionet dhe Partneritetin Publik/Privat’, për negociimin pa shpallje të kontratës koncesionare për ndërtimin e inceneratorit të Elbasanit”, vijon Blushi.

Në përfundim, ai deklaron se nuk pret dorëheqjen e kryeministrit dhe bën thirrje për largimin e tij nga pushteti, duke përdorur një gjuhë të ashpër ndaj Ramës.

“Shporrja, dhe vetëm shporrja, është e vetmja zgjidhje që duhet ta marrin në dorë shqiptarët!”, përfundon Blushi.

LAJMET KRYESORE



Mesazh urgjent i kryeministrit Rama sapo mbërriti nga SHBA (fjala e plotë)



A do të shkojë ambasadori Wendt në Selinë Blu për të takuar Berishën?



Shqipëria fiton me dy gola ndaj Bjellorusisë



Mirë se vjen, Ambasador Wendt!



Presidenti Begavidi zbardh takimin me ambasadorin e ri të SHBA, Eric Wendt

TË PËRZGJEDHURA



Singapori paguan qytetarët për të lexuar: 15 minuta në ditë në këmbim të parave



David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hije! Balluku-lokomotivë shtetfo...



Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude



Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...

MË TË LEXUARAT

Reagimi i plotë: Edi Rama vërtetoi sot jo vetëm kartelën e tij klinike, por edhe papërgjegjshmërinë e një kleptomani dhe arrogancën e një banditi, që drejton me gjakftohtësi organizatën kriminale, që ka marrë peng të gjithë shtetin. Ky mashtrues i pacipë, që sfidoi sot këdo duke pretenduar se nuk ekziston asnjë vendim apo firmë e tij në shkelje të ligjit, ja ku i ka dy gjurmë, që ulërasin në dritën e diellit.

1. Edi Rama, në kundërshtim me çdo ligj në fuqi, më 7.12.2016 firmosi dhënien e bonusit prej 8% të pikëve kompanisë Integrated Energy BV sh.p.k. për procedurën konkurruese për ndërtimin e inceneratorit të Tiranës. Por, në fakt, kjo kompani NUK EKZISTONTE në momentin kur Kryeministri firmosi bonusin që e favorizonte atë në procedurën konkurruese.

2. Edi Rama ka firmosur, në kundërshtim me ligjin "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik/Privat", për negocimin pa shpallje të kontratës koncesionare për ndërtimin e inceneratorit të Elbasanit, edhe pasi Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Engjëll Agaçi, ishte njoftuar zyrtarisht nga Drejtori i Agjencisë së Prokurimeve Publike, z. Eduard Ahmeti, se procedura e përzgjedhur për dhënien e këtij koncesioni (negocimi pa shpallje) ishte e paligjshme.

Askush të mos lodhet duke pritur dorëheqjen e tij dhe as të mos ngjiret me kërkesën për largimin e vullnetshëm të tij nga pushteti.

Asnjë hajdut nuk vjedh për t'ia dorëzuar më pas plaçkën policisë.

Asnjë bandit nuk vetëndalet me ndërgjegje në kriminalitetin e vet.

Shporrja, dhe vetëm shporrja, është e vetmja zgjidhje që duhet ta marrin në dorë shqiptarët!

Ky është i vetmi ilaç për shpëtimin e Republikës, të marrë peng nga një i sëmurë mendor, kleptoman dhe mafioz i pandreqshëm!

MË SHUMË NGJA AKTUALITETI



Polonia ofrohet 'të strehojë' fabrikën e sistemeve “...



Nënkryetari i PD, Belind Këlliçi: Edi Rama nuk do ta mbajë dot me for...



"Rasti Ante Gotovina" nisi të përmendej nga avokatët, si pikë referen...





Zoti Rama: Cilët janë mediat me evazion “marramendës fiskal”?



Mblidhen “Plisat” kundër aktgjykimit në Hagë, protestës u bashkohen e...



Papa Leoni XIV: Vetëm Zoti e shuan etjen e njeriut për lumturi, rreza...

LAJMET E FUNDIT



Polonia ofrohet ‘të strehojë’ fabrikën e sistemeve “Patriot” për Ukrainën

[12 MINUTA MË PARË](#)



Nënkryetari i PD, Belind Këlliçi: Edi Rama nuk do ta mbajë dot me forcë pushtetin!

[19 MINUTA MË PARË](#)




“Rasti Ante Gotovina” nisi të përmendej nga avokatët, si pikë reference për fazën e apelit të Çlirimtarëve

[34 MINUTA MË PARË](#)



Zoti Rama: Cilët janë mediat me evazion “marramendës fiskal”?

[42 MINUTA MË PARË](#)



Mblidhen “Plisat” kundër aktgjykimit në Hagë, protestës u bashkohen edhe grupet e tjera të tifozëve

[44 MINUTA MË PARË](#)

Rama: E përsëris, unë mund të kem fajet e mia me siguri, nuk jam ëngjëll e as i pagabueshëm nuk jam jo e jo...

[47 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONE

Gazeta “KOHA JONË” themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga “Samir Frasheri”, Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

